



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:174784

Datë: 10.12.2023

Numri i dokumentit: 05040219

P.nr.907/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi – Imami, në çështjen penale kundër të pandehurve A.M .nga fsh. G. K. P. dhe A. M. nga fsh. G. K. P, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2083/20, të dt.02.12.2020, jashtë seancës, me datë 10.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër reference Nd.nr.2381/23 e datës 05.12.2023, e lidhur në mes të pandehurve A.M. nga fsh. G. K. P, A. M. nga fsh. G. K. P. dhe të dëmtuarit R. B, nga fsh. K. e M. K. K.

II.HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2083/20, e datës 02.12.2020.

III.PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve A.M. nga fsh. G. K. P. dhe A. M. nga fsh. G. K. P, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

IV. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.2083/20, të dt.02.12.2020, kundër të pandehurve A.M. nga fsh.G. K. P. dhe A. M. nga fsh. G. K. P, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata, me datë 05.12.2023 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit L. H. dhe të pandehurit A.M. dhe A. M.

Para leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit i propozojnë gjykatës që lënda të shkojë në procedurë të ndërmjetësimit, pasi që janë pajtuar me palën e dëmtuar.

Pas marrjes së miratimit nga ana e prokurorit të shtetit lënda është dërguar në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë.

Qendra e Ndërmjetësimit në Pejë me datë 05.12.2023 e ka njoftuar gjykatën se të pandehurit dhe i dëmtuari janë pajtuar dhe kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësimit me numër reference Nd.nr.2381/23 me datë 05.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, gjeti se palët kanë lidhur marrëveshjen e ndërmjetësimit me vullnet të lirë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-009 Për Ndërmjetësim, përkatësisht nenet 12 dhe 15 paragrafi 1, andaj të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit , përkatësisht hedhi aktakuzën dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit, duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 5 dhe nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga të lartë cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 907/20 me datë 10.12.2023

Gj y q t a r i
Veton Ademaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.